

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE INF.SJP-A

Nr. 1235 Prot

Tiranë, më 16/06/2026

URDHËR

Nr. 66, datë 16/06/2026

**PËR KRYERJEN E LEJES VJETORE TË VITIT 2026 PËR STRUKTURAT
AKADEMIKE DHE NDIHMËSAKADEMIKE TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE SI
DHE CAKTIMIN E PERIUdhËS SË PUSHIMIT DIMËROR**

Mbështetur në nenin 92 dhe 93 të ligjit nr. 7961, datë 12.07. 1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, në nenin 39, pika 5 të ligjit “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në pikën 10 të Vendimit nr. 329, datë 12.04.2017 të Këshillit të Ministrave “Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik”, në Udhëzimin nr. 27, datë 29.12.2017 për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë si dhe në Statutin e Universitetit të Arteve, i ndryshuar, në cilësinë e titullarit të institucionit,

URDHËROJ:

1. Miratimin e datave për kryerjen e lejes vjetore për personelin ndihmësakademik në Universitetin e Arteve, nga data 16 Korrik 2026 deri më 16 Gusht 2026.
 - Data e paraqitjes në punë për personelin ndihmësakademik është 17 Gusht 2026.
2. Miratimin e datave për kryerjen e lejes vjetore për personelin akademik të Universitetit të Arteve, nga data 6 Korrik 2026, deri më 18 Gusht 2026.
 - Data e paraqitjes në punë për personelin akademik është 19 Gusht 2026.
3. Personeli akademik, deri më datë 6 Korrik (që përkon me ditën e parë të fillimit të lejes), duhet të ketë plotësuar këto detyrime: provime, procesverbale, evidenca të ngarkesave mësimore dhe çdo dokumentacion tjetër të detyrueshëm për t’u plotësuar dhe për t’u

dorëzuar në strukturat përkatëse apo çdo detyrim tjetër që mund të ketë në njësinë përkatëse apo në institucion.

4. Miratimin e periudhës së pushimit dimëror për personelin akademik dhe studentët e Universitetit të Arteve nga data 21 Dhjetor 2026 deri më 4 Janar 2027. Veprimtaria mësimore dhe akademike do të fillojnë më datë 5 Janar 2027.
5. Anëtarët e personelit akademik dhe ndihmësakademik që për arsye pune ndërpresin lejen vjetore me urdhër të Rektorit, do ta vijojnë lejen vjetore sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.
6. Anëtarëve të personelit akademik dhe ndihmësakademik, të cilët kanë shfrytëzuar disa ditë të lejes vjetore të vitit 2026 me urdhër të titullarit deri në momentin e daljes së këtij urdhri, do t'u zbriten përkatësisht këto ditë nga kuota e lejes vjetore për vitin 2026.
7. Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore Inf.SJP-A, të marrë masat për zbatimin e pikave 5 dhe 6 të këtij urdhri.
8. Publikimin e këtij urdhri në faqen zyrtare të UART.
9. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore Inf.SJP-A, Drejtoria Ekonomike & Investimeve dhe Fakultetet e Universitetit të Arteve si dhe një kopje e tij t'i dërgohet Administratorit të Universitetit të Arteve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. Erald Bakalli

